



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR

RREGULLORE

Nr. 3, datë 01.02.2007

FUNKSIONIMIN E DEGËS DHE TË SEKSIONIT TË IKM-së

Bazuar në nenet 16 dhe 27 të Statutit të IKM, me qëllim që të rregullojë funksionimin e organeve drejtuese të degëve e seksioneve të tij në rrethe, Këshilli i Drejtimit i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar harton këtë Rregullore

1. Krijimi i Seksioneve dhe Degëve

Në varësi të numrit dhe prirjes drejt rritjes, në të dy kategoritë e anëtarësisë në IKM, (a) anëtarë me të drejta të plota dhe (b) kandidatë aspirantë (aplikantë) për të fituar titullin “Kontabël i Miratuar”, në rrethe mund të ngrihen e të funksionojnë seksione ose degë.

Degët dhe/ose Seksionet krijohen në cdo rreth apo grup rrethesh, me miratimin e Këshillit të Drejtimit.

Në ato rrethe ku ka mbi 20 anëtarë dhe ky numër ka tendencë të rritet mund të krijohen degë të IKM-së, ndërsa në ato rrethe ku numri i anëtarëve nuk i kalon 20 vetë mund të krijohen seksione të IKM-së. Vec kësaj, disa seksione që kanë afersi gjeografike, duke u bashkuar me njëri tjetrin, mund t'i kërkojnë Këshillit të Drejtimit të IKM-së miratimin e krijimit të degës ose seksionit për rajonin gjeografik.

2. Organet drejtuese të Degës e Seksionit

Organi drejtues më i lartë i Degës është Mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të degës. Kryesia e Degës drejton Degën në periudhën midis dy mbledhjeve të përgjithëshme të zakonshme të anëtarëve. Ai përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të degës, me një mandat 4 vjeçar me të drejte rizgjedhje vetëm një herë, sipas të njëjtave modalitete që përdoren edhe për zgjedhjen e anëtarëve të KD të IKM.

Organi Drejtues më i lartë i seksionit është mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të seksionit. Kryesia e Seksionit drejton seksionin në periudhën midis dy mbledhjeve të përgjithëshme të zakonshme të anëtarëve të seksionit. Ai përbëhet nga 3 anëtarë të

